



AGROKREDIT

Tirane, 03.09.2019

NJOFTIM

FTESË PËR NEGOCIATA

Agrokredit sh.a njofton se në datën 10.09.2019, ora 14.00 do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: “Fushata e integruar e marketingut per promovimin mediatik të shoqerise Agrokredit sh.a”.

Të gjithë të interesuarit (Organe të masmedias/agjenci të specializuara) janë të ftuar të marrin pjesë në këtë procedurë e prokurimi.

Bashkelidhur Ftesa per Negociata per proceduren e prokurimit me objekt: “Fushata e integruar e marketingut per promovimin mediatik të shoqerise Agrokredit sh.a”



Tirane, 03.09.2019

FTESË PËR NEGOCIATA

Agrokredit sh.at njofton se do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: **“Fushata e integruar e marketingut per promovimin mediatik të shoqerise Agrokredit sh.a”**.

Fondi limit i procedures është: 5,831,570 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh

Lloji i procedurës: Procedure e mbështetur në nenin 7 të ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1195, datë 5.8.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht më e favorshme sipas kriterëve që jepen në vijim:

Vlerësohet me 30 (tridhjetë) pike: Projekt-ide e realizimit të spotit, sipas cilesise se parashikuar ne termat e references

Projekt ideja do të vlerësohet nga Komisioni, në varësi të projekt idesë më të mirë të paraqitur.

Vlerësohet me 70 (shtatëdhjete) pikë; Cmimi më i ulët i ofruar në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta (sipas logjikës së formulës më poshtë).

Vlerësimi i cmimit kryhet sipas formulës se mëposhtme:

Pe- Piket për cmimin

Çu- Çmimi me i Ulet i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi me i ulet*)

Pe = 70 x Çu / Ç

(çmimi me i ulet merr piket maksimale për çmimin)

Vlerësimi përfundimtar = pikët për projekt idenë + pikët për cmimin.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 10.09.2019, ora 14.00.

Vendi: Agrokredit.sha.

Adresa: NJA Nr.2, Rruga Elbasanit, Nt 178/1,Tiranë

Tel: +355 4 2 223937

Fax: +355 4 2 223937

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 10.09.2019, ora 14.00.



AGROKREDIT

Vendi: Agrokredit.sha.
Adresa: NJA Nr.2, Rruga Elbasanit, Nt 178/1,Tiranë
Tel: +355 4 2 223937
Fax: +355 4 2 223937
Adresa e Internetit: www.agrokredit.al

Gjuha per hartimin e ofertave: Shqip

Termt e References

Historik

Agrokredit sh.a eshte nje institucion i miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 904, date 27.06.2008, ne formen e nje shoqerie aksionere me kapital teresisht shteteror me aksioner te vetem Ministrin e Financave dhe Ekonomise, e licensuar nga Banka e Shqiperise ne kredi- dhenie.

Agrokredit sh.a planifikon te intensifikoje e te rrise publicitetin me fushata promocionale, ne qarqet (rrethet) ku ka dege te Agrokredit sh.a, duke transmetuar spotin e saj ne televizionet kombetare dhe lokale, permes te cileve mund te realizohet informimi me i gjere per prospektet e synuara.

Fushatat publicitare ne median elektronike do te japi nje impakt pozitiv ne rritjen dhe forcimin e imazhit dhe markes Agrokredit sh.a ne tregun e biznesit financiar bankar dhe mikrofinanciar Shqiptar, tek klientet ekzistues dhe ata potencial.

Objektivi i konsulences

Objektivi i kesaj konsulence eshte intensifikimi dhe publiciteti me fushata promocionale, ne qarqet (rrethet) ku ka dege te Agrokredit sh.a, duke transmetuar spotin e saj ne televizionet kombetare dhe lokale, permes te cileve mund te realizohet informimi me i gjere per prospektet e synuara.

Qellimi i punes

Konsulenti duhet te realizoje krijimi dhe konceptimin e fushates Agro Kredit, prodhimin e spotit televiziv dhe transmetimin e spotit televiziv në 3 televizione kombëtare, perfshire kanalin publik RTSH dhe televizionet lokale ne rrethe Lushnje, Berat, Kavaje, Fier, Korce.

Produkti i pritshem.

Per te kompletuar detyren e marre persiper, organi i masmedias/agjencia e specializuar duhet te realizoje krijimin dhe konceptimin e fushates Agrokredit sh.a, prodhimin e spotit televiziv dhe transmetimin e spotit televiziv ne



formatin e percaktuar ne specifikimet teknike dhe te pranuar nga AgroKredit sh.a si poshte vijon:

| Nr. | Emertimi | Pershkrimi | Njesia | Sasia |
|-----|--|---|-----------------------|-------|
| 1 | Konceptimi dhe krijimi i fushates Agro Kredit | Konceptimi dhe krijimi i fushates Agro Kredit si dhe projekt skenari paraprak per krijimin e spotit televiziv. | | 1 |
| 2 | Prodhim Spoti TV | Spoti i prodhuar do te jete me xhirim te planeve te ndryshme, blerje materialesh nga televizione, blerje materiale nga banka e videove, montazh, perpunim ne postproduction dhe color correction, regjistrim zeri, perpunim zeri, kamera me qera, ndricim duke perfshire dhe perdorim te spotit (dhe personazheve te perfshira ne te) per nje periudhe 6 mujore. Ne menyre te detajuar perfshihen: <ul style="list-style-type: none">• Ideimi dhe krijimi i spotit;• Regjistrimi, pastrimi dhe montimi i zërit narrativ;• Shoqërimi i zërit me muzikë shoqëruese dhe efekte të tjera audio;• Muzika duhet të jetë origjinale ose e shoqëruar me të drejtat e përdorimit;• Renderizimin e spotit në format 4x3 (SD) dhe format 16X9 (SD dhe HD) i gatshëm për transmetim; HD 16:9,1920 x 1080, mpeg• Dorëzimin e spotit në 3 DVD, në format origjinal të pakonvertuar.• Spoti nuk duhet te jete me pak se 30"• Personat pergjegjes te shoqeruar me CV perkatese: Drejtori Artistik, Regjizor, Montazhier, Dizenjues dhe Menaxheri i Projektit | Cope | 1 |
| 3 | Transmetim Spoti TV | <ul style="list-style-type: none">• Transmetimi i spotit televiziv në 3 kanale kombëtare (perfshire kanalin publik RTSH), me te pakten nga 1 spot në ditë brenda fashës orare 12:00PM-23:30PM dhe në televizionet lokale në rrethet: Berat, Lushnjë, Fier, Kavajë, Korce me të paktën nga 2 spote në ditë.• Strategji e detajuar dhe e shoqëruar me media planin perkates. Kohëzgjatja e transmetimit në media, do të jetë 30 (tridhjetë) ditë rresht, gjate periudhes Tetor-Nentor 2019. | Spote 30 " Ekuivalent | 1953 |

Afatet kohore dhe raportimet

Kohëzgjatja e kontrates do te jete 90 dite. Organi i masmedias/agjencia e specializuar sipas përcaktimit qe do te behet ne planin e aktivitetit, do te pergatise nje draft te materialit dhe do ta paraqesi prane AgroKredit sh.a per komente. Konsulenti duhet te dorëzoj versionet finale ne 3 (tre) DVD sipas afateve te meposhtme.

| NR | Emertimi | Afati |
|----|--|--|
| 1 | Konceptimi dhe krijimi I fushates Agro Kredit | 1 jave nga data e lidhje se kontrates. |
| 2 | Prodhim Spoti TV | 4 jave nga data e lidhje se kontrates. |



| | | |
|----------|----------------------------|---|
| 3 | Transmetim Spoti TV | Kohëzgjatja e transmetimit në media, do të jetë 30 (tridhjetë) ditë rresht gjate periudhes Tetor-Nentor 2019. |
|----------|----------------------------|---|

* Ne afate perfshihen dhe koha per komentet e klientit dhe korrigjimet nga konsulenti. Ne perfundim te cdo faze do te merret miratimi nga ana e Klientit. Data e fillimit te transmetim do te dakordesohet midis Klientit dhe Konsulentit pas perfundimit te fazes se dyte.

Informacioni qe do te ofrohet nga AgroKredit sh.a

Konsulentit do ti ofrohet informacioni i nevojshem nga ana e AgroKredit sh.a lidhur me informacionin e nevojshem me qellim realizimin me sukses te kontrates.

Konsulenti do te punoje nen supervizionin e Departamentit te Shitjes dhe Marketing Zhvillimit.

Pagesa

Pagesa e konsulentit do te kryhet kundrejt dorezimit te fatures perkatese ne perfundim te cdo faze.

| NR | Emertimi |
|----------|--|
| 1 | Konceptimi dhe krijimi I fushates Agro Kredit |
| 2 | Prodhim Spoti TV |
| 3 | Transmetim Spoti TV |

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet te deklaroje se:

- Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- nuk është dënuar për shkelje penale.
- nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.



Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe termave të references.*
- d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit*

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit 2016-2017-2018, vlera e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të kontratës.

2.3. Për kapacitetin teknik:

3. Organi i masmedias/agjencia e specializuar duhet te kete realizuar gjate tre viteve te fundit sherbime te ngjashme me vlere jo me pak se 40% e e vleres së përlllogaritur të fondit limit. Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- a) Si deshmi per pervojen e meparshme te realizuar me Ent Publik kerkohen:
 - Vërtetim te lëshuar nga enti publik për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate si dhe faturat tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara
- b) Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat kerkohen si deshmi:
Fatura/t tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

2.4. Media Plan paraprak per shperndarjen / transmetimin.

2.5. Organi i masmedias/agjencia e specializuar duhet te përgatise 1 (nje) projekt - ide te spotit sipas cilesise se parashikuar ne termat e references dhe ti dorezoje ne hard copy (1 kopje), se bashku me Formularin e Deklarimit të Ofertës.



2.6. Deklarate qe transmetimi i spotit do te jepet nga organet e masmedias, te cilat jane aktive dhe te licensuara sipas legjislacionit ne fuqi.

Dokumentacioni të jetë original ose kopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj.

Mbi zarf të jetë shënuar “**ofertë për proceduren: Fushata e integruar e marketingut per promovimin mediatik të shoqerise Agrokredit sh.a**”.

Monitorimi i publicitetit do të kryhet sipas përcaktimeve që do të vendosen në kontratën e shërbimit ndërmejt palëve

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Agrokredit sh.a.

Në procesin e hapjes së ofertave kanë të drejtë të marrin pjesë Ofertuesit apo personat me autorizim.

Komisioni pret konfirmimin nga organet e masmedias/të Agjencive të specializuara për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Agrokredit sh.a